



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

HAPAT PROCEDURALË TË UNIFIKUAR

Për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Mbështetur në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Me qëllim unifikimin e procedurave të shqyrtimit të çështjeve nga trupat gjykuese;

Bazuar mbi parimin e transparencës, parimin e procesit të rregullt ligjor, parimin e gjykimit të shpejtë, parimin e hetimit kryesisht, parimin e barazisë dhe parimin e eficiencës;

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit unifikon hapat proceduralë që ndiqen nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit.

Hapa proceduralë

1. Trupa gjykuese në ditën e hedhjes së shortit dhe në vazhdim, në përputhje me dispozitat e Rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, konsiderohet përgjegjëse për hetimin dhe përfundimin e procesit në bazë të ligjit.
2. Njoftimi dhe çdo komunikim midis subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të bëhet në adresën elektronike të vendosur nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë. Në rast se njoftimi nuk realizohet me anë të adresës elektronike, do të përdoren format e tjera të komunikimit, parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative.
3. Brenda 15 ditëve nga hedhja e shortit sipas “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, çdo trupë gjykuese zhvillon mbledhjen e parë, në të cilën ndërmerren këta hapa:
 - Deklarohet konflikti i interesit nga anëtarët e trupës gjykuese;
 - Zgjidhet kryesuesi i trupës gjykuese për çdo dosje;
 - Bëhet prezantimi paraprak i dosjes nga çdo relator;
 - Vendoset për njoftimin e subjektit të rivlerësimit për fillimin e procedurave të rivlerësimit; njohjen me përbërjen e trupës gjykuese dhe të drejtën e deklaramit të konfliktit të interesit, si dhe dërgimin e pyetësorit tip;
 - Vendoset për fillimin e hetimit kryesisht, si dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave

të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

Deri në përfundim të hetimit, relatori mund t'i kundërdrejtojë subjektit pyetje shtesë, të cilat i konsideron të nevojshme për hetimin.

4. Relatori i çështjes, pasi studion dosjen, ndërmerr hapat proceduralë për të garantuar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjyquese. Këshilltari juridik dhe këshilltari ekonomik i çështjes japin opinion dhe përgatisin relacionin e tyre paraprak në lidhje me hapat proceduralë të ndërmarrë dhe rezultatet e hetimit.
5. Relatori i çështjes njofton rregullisht vëzhguesin ndërkombëtar për hapat proceduralë të ndjekur dhe rezultatet e hetimit. Vëzhguesi ndërkombëtar ka akses të plotë në çdo dokument përbërës të dosjes.
6. Në përfundim të hetimit kryesisht dhe vlerësimit të fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, relatori, i ndihmuar nga këshilltari ligjor dhe këshilltari ekonomik, përgatit relacionin paraprak të hetimit, ua përcjell anëtarëve të trupës dhe njofton kryesuesin për thirrjen e mbledhjes së trupës, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar. Në këtë mbledhje, trupa gjyquese, pasi dëgjon relatorin, shqyrton gjetjet dhe/ose mendimin me shkrim të vëzhguesit ndërkombëtar dhe jep opinionin për vazhdimin e hetimit kryesisht ose mbylljen e tij.

Në rast të vazhdimin të hetimit kryesisht, relatori merr masa për kryerjen e procedurës së nevojshme.

Kur trupa gjykon se janë ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm hetimorë për përfundimin e hetimit kryesisht, merr vendim për (i) përfundimin e tij dhe (ii) njoftimin e subjektit si më poshtë vijon:

- a. Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht.
- b. Për rezultatet e këtij hetimi.
- c. Nëse provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 52 të ligjit 84/2016, njoftimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e barrës së provës sipas paragrafit 5 të nenit Ç, paragrafit 5 të nenit D, paragrafit 4 të nenit DH dhe paragrafit 5 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës.
- d. Të drejtën për t'u njohur me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrë një kopje të tyre. Dosja i vihet në dispozicion subjektit sipas neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke respektuar të drejtat e palëve sipas neneve 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative.
- e. Të drejtën e subjektit për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse. Kjo kërkesë duhet të përmbajë të gjitha informacionet e

nevojshme për identifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit, si dhe të dhëna mbi thelbin e informacionit të prishëm.

- f. Afatin brenda të cilit duhet bëjë kërkesën me shkrim për njohjen me dosjen dhe të paraqesë prova/ shpjegime me shkrim apo të bëjë kërkesa në përputhje me pikat “d” dhe “e” të kësaj pike. Ky afat nuk mund të jetë më pak se 5 ditë dhe jo më shumë se 20 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t’u njohur me dosjen.
7. Në rast se subjekti deklaron konfliktin e interesit me anëtarët e trupës gjyquese, përjashtimi i komisionerit do të vendoset nga një trupë tjetër gjyquese, në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 84/2016.
8. Brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës së subjektit për thirrjen e një dëshmitari apo marrjen e një prove, trupa gjyquese, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendos me arsyetim për pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në rast se kjo kërkesë pranohet, relatori i çështjes ka detyrimin të marrë deklarimin/provën mbështetëse, ta vlerësojë atë dhe ta përfshijë në relacionin përfundimtar.
9. Në rast se dosjes së një subjekti të rivlerësimit, i cili e ka ushtruar të drejtën e tij/saj për t’u njohur me dosjen, i shtohen prova apo fakte të reja, që ndikojnë në vendimmarrje, për të cilat subjekti nuk ka marrë dijeni, ky subjekt do të njoftohet përsëri për t’u njohur me to, sipas procedurës më sipër.
10. Kur dosja është gati, pasi ka përfunduar edhe afati për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim nga subjekti, relatori përgatit relacionin përfundimtar dhe ia vë në dispozicion trupës dhe vëzhguesit ndërkombëtar.
11. Trupa, në mbledhjen e thirrur nga kryesuesi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, mund të vendosë për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore. Në këtë rast trupa vendos për njoftimin e subjektit, për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t’u dëgjuar në seancë.
12. Seanca dëgjimore është publike dhe zhvillohet sipas përcaktimeve në nenin 20 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.
13. Seanca dëgjimore hapet nga kryesuesi i trupës gjyquese, i cili pasi identifikon subjektin e rivlerësimit dhe/ose përfaqësuesin e tij, prezanton trupën gjyquese dhe ia jep fjalën relatorit të çështjes. Relatori i çështjes bën një përmbledhje të shkurtër të dosjes, si dhe të hapave proceduralë hetimorë të ndërmarrë. Pas relatorit, i jepet fjala subjektit të rivlerësimit/përfaqësuesit të tij, për të bërë një deklaratë fillestare mbi themelin e

çështjes. Koha e caktuar për këtë mund të kufizohet në mënyrë të arsyeshme nga kryesuesi i trupës gjyqësore.

14. Në rast se subjekti pranon t'u përgjigjet pyetjeve në bazë të pikës 3 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, anëtarët e trupës gjyqësore dhe/ose vëzhguesi ndërkombëtar mund t'i drejtojnë pyetje në lidhje me çdo çështje objekt rivlerësimi. Në përfundim të seancës, subjekti i rivlerësimit mund të bëjë një deklaratë përmbyllëse, koha e së cilës përcaktohet nga kryesuesi i trupës gjyqësore.
15. Bisedimet për marrjen e vendimit bëhen në përputhje me pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
16. Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore nga kryesuesi i trupës gjyqësore.
17. Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesit ndërkombëtar.
18. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të institucionit *kpk.al*, duke respektuar kërkesat e ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
19. Për të gjitha shortet pararendëse të hedhura, njoftimi i subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupës gjyqësore dhe të drejtën e deklaramit të konfliktit të interesit, do të kryhet sipas pikës 3, fjalia 5.

Miraturar me vendimin nr. 7, datë 12.2.2018 të Komisionit.

Ndryshuar me vendimin nr. 28, datë 8.5.2018 të Komisionit.